

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QENDER PERENDIM
TIRANE

DREJTORI
ERION KOKA

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë: “Rot. Ibë - Qafë Krrabë (Km 29),Elbasan (Bradashesh) -Kaçolitë(km 29), Elbasan (Ura) – Gjinar” (52.6 km) (Kontrata Nr.4)

- **Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen**

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, sipas Specifikimeve Teknike.

- **Segmentet që mbulon kontrata**

Nr. Rrugës	Indeks	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)
		MIRËMBAJTJE RUTINË		
3	4/3	rot. Ibë - Qafë Krrabë (Km 29)	SMTW	11.9
3	4/4	Elbasan(Bradashesh) - Kaçolite	SMTW	19.5
71	6/4	Elbasan (Ura) – Gjinar	SMTWM	21.2
		GJATËSIA KM KONTRATA 4		52.6

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, , SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore, SMTWM – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

- **Kusht i veçantë**

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

- **Sinjalistika dhe siguria rrugore**

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

- **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

Rot. Ibë - Qafë Krrabë


Ky segment rrugor është pjesë e rrugës së vjetër nr. 3. Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në kushte të mira. Kanalet anësore dhe tobinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Elbasan(Bradashesh) – Kaçolitë

Ky segment rrugor është pjesë e rrugës së vjetër nr. 3.


Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në kushte të mira. Kanalet anësore dhe tobinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Elbasan (Ura) – Gjinar

Ky segment rrugor është vazhdim i rrugës nr. 71, Elbasan – Zavaline

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.


Shtresat asfaltike janë në gjendje jo të mire (pasi ka qe ne vitin 2009 me nje shtrese binder), trupi i rruges ne disa vende ka rreshqitje dhe çedime, nga te cilat deporton uji ne shtresat e trupit te rruges . Ka demtim te murit mbajtjkes te nje shpatulle te ures ne km 15.5 (spostimi eshte 35-40 cm) , ka nevojte per nje studim me te detajuar . Ne kete segment rrugor ka disa rreshqitje te trupit te rruges per shkak te terrenit. Keto rreshqitje kane nevojte per studim te detajuar . Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore mungojne per gjate gjithe gjatesise se segmentit. kanë nevojë per vendosjen e tyre.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk te larte..

Niveli i kërkuar i shërbimit “minimal”.

Theksojme se per kete segment rrugor eshte e nvijshme rritja e sigurise rrugore. Per kete duhet te behet investimi nga ARRSH ne gjithe gjatesine e ketij segmenti.



Përgatitën

Rajmonda Levanaj

Xhuljana Shehu

Brunilda Kodra

Ismail Ruçi

Xhevdet Mulaj

Mondi Sako

Donika Mihali

